

## KONTRATE SHITJE KUOTE

Ne Tirane, sot me date 01/09/2021, palet si me poshte hartuan kete kontrate shitje:

### SHITESI:

**Elona Bisha** e bija e Mehmetaliut, e dtl. 05.02.1978, lindur ne Tirane dhe banuese ne: Rruga Vehbi Agolli, Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr. personal H85205164V;

Shitesi Elona Bisha, eshte ortak ne shoqerine Business & Tax Advice shpk, shoqeri tregtare shqiptare me NIPT M01426010C, me seli ne Rruga Sami Frasheri, Ndertesa 19, Hyrja 8, kati 5, Ap.14, Tirane dhe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 90% te kapitalit me vlere 900,000 (nenteqind mije) leke.

### BLERESI:

Blerta Bendo e bija e Metit, e dtl. 09.04.1973, lindur ne Lushnje dhe banuese ne: Rruga Perlat Rexhepi, Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr. personal H35409135N;

---

### Objekti i kontrates


Asambleja e ortakeve te shoqerise me vendimin e saj date 01/09/2021, bazuar ne Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe Statutit te Shoqerise, ka vendosur: "Shitjen e 90% te kapitalit te zoteruar ne shoqeri nga ortaku Elona Bisha, blesisit Blerta Bendo".

### Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes se kuotes, qe perfaqeson 90 % te kapitalit te zoteruar nga ortaku Elona Bisha, qe transferohet nepermjet kesaj kontrate shitje ne favor te blesisit Blerta Bendo eshte 900,000 (nenteqind mije) leke.

### Garancite

Shitesi deklaroi dhe garantoi se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotes qe po transferohet nepermjet kesaj kontrate dhe se ato jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjeter ligjor.



### Kalimi i titullit te pronesisë

Shitesi dhe Bleresit pergjigjen në menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e rregjistrimit te kalimit. Shoqëria regjistron kalimin e kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, te ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Nje kopje e kesaj kontrate shitjeje do te depozitohet menjehere prane Qendres Kombetare te Biznesit, ne menyre qe te behet kalimi i menjehershem i kuotave ne pronesi te bleresit.

### Heqje dore nga te drejtat dhe detyrimet

Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale se heq dore nga te gjitha te drejtat qe i takojne mbi kuoten qe po i transferon nepermjet kesaj kontrate shitjeje ne favor te Bleresit Blerta Bendo, i cili behet pronar i ligjshem te kesaj kuote.

### Te ndryshme

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.


Kjo Kontrate me objekt Shitje Kuotash, eshte hartuar ne baze te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise si dhe Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kontrate u hartua ne 3 kopje me vlere te njejte ligjore, ne gjuhen shqipe dhe palet pasi e lexuan, e kuptuan, deklaruan se jane dakort me sa me sipër, dhe e nenshkruan regullisht.

**Shitesi**

Elona Bisha



**Bleresi**

Blerta Bendo

